PEJGAMBERË NË LUTJE...

S'KAM KOHË, SE MË DUHET TË DAL NË KAFE...

ALLAHU MË NXORI NGA FAMILJA DHE MË SOLLI TEK TI, PËR TË KRYER HALLIN TËND...

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 19 - Nr. 12 (226), Dhjetor, 2021

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

"Kurani, mrekullia udhëzuese"

Konferenca e 10-të vjetore e imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës

I RIU BELG DËSHMON SHEHADETIN PARA DUARVE TË MYFTIUT TË SHKODRËS

Një emocion i jashtëzakonshëm dhe një ndjesi e mrekullueshme, teksa ndjeja sinqeritetin dhe dorëzimin e tij në këtë bejat shekullor, që përsëritet brez pas brezi në madhështinë e dëshmisë së madhe: "Do të mbërrijë kjo fé, ku ka mbërritur nata dhe dita", dëshmi që na e shton edhe më shumë lidhjen dhe dashninë e Resulullahut (a.s)!

Mirë së erdhe në familjen tënde të madhe, i dashtuni Jules! Viteve të fundit, numri i evropianëve dhe...

(f. 16)

AKTIVITET KULTUROR PËR DITËN BOTËRORE TË GJUHËS ARABE

Paraditen e ditës së shtunë, më 18 dhjetor 2021, Myftinia Shkodër zhvilloi një aktivitet kulturor me rastin e 18 dhjetorit, të shpallur nga UNESCO si Dita Botërore e Gjuhës Arabe.

Përveç përfaqësuesve dhe imamëve të Myftinisë, ishin të pranishëm edhe intelektualë të qytetit, të rinj dhe dashamirës dhe njohës të gjuhës arabe.

Teulogu Arben Halluni në fjalën e tij të hapjes tha se ky është aktiviteti i parë që organizon Myftinia...

(f. 15)

PEJGAMBERË NË LUTJE...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Kushdo që lexon në Kuranin Famëlartë, do të gjejë në shumë vende shembuj të spikatur të lutjeve plot përkushtim të pejgamberëve të dërguar, sipas rrethanave dhe situatave të ndryshme në jetën e tyre.

Përtej larmisë së këtyre lutjeve, ka një mësim të madh, që na drejtohet në çdo kohë e situatë dhe që është se njeriu, përtej pozitave dhe gradëve të besimit dhe përkushtimit në jetë, përherë është nevojtar për Zotin, dyert e të Cilit nuk mbyllen kurrë për robin e Tij, edhe jobesimtar të jetë! Thotë: "O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd".[1]

Mësojmë dhe kuptojmë se lutja është një mundësi e madhe për të ndryshuar realitetet dhe vështirësitë e jetës sonë, pa të cilat kjo jetë s'do kishte kuptim dhe për të cilën Allahu i Madhëruar na mëson se: "Ju, me siguri, do të sprovoheni në pasurinë e në jetën tuaj dhe do të dëgjoni shumë fyerje nga popujt që iu është dhënë Libri para jush, si dhe nga paganët. Por, nëse ju duroni dhe ruheni (nga të këqijat), atëherë kjo është vërtet përcaktuese e çështjeve.".[2]

Kështu, njeriu është i ftuar që të mësojë artin e lutjes, të edukohet me Zotin e tij, të respektojë urdhëresat, të largohet nga ndalesat, të kontrollojë burimet e rizkut të tij dhe mbi të gjitha, të jetë prezent me zemrën e tij, jo i hutuar a i shpërqendruar në lutje. Sepse, siç kemi mësuar nga edukatorët tanë: "Prej etikës së lutjes, është prezenca e zemrës dhe njeriu të mos jetë i hutuar, sepse është transmetuar se Resulullahu (a.s) ka thënë: 'Allahu i Madhëruar nuk i përgjigjet lutjes së robit, nga një zemër e shpërqendruar'.[3]

Ndërsa prej kushteve të saj, është burimi hallall i rizkut, sepse Resulullahu (a.s) i tha Sadit (r.a): 'Le të jetë ushqimi yt i pastër, të të përgjigjet lutja jote!'[4]...".[5]

Nga një vështrim i shpejtë në Librin e Allahut, shohim madhështinë e lutjes në jetën e Mësuesve të Mëdhenj të njerëzimit, si një dëshmi e mrekullueshme që na fton të mos hezitojmë e të mos lëmë pas dore këtë sekret të madh që na është dhënë në komunikimin tonë të përhershëm me Zotin e gjithësisë, që na fton: "Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.".[6]

Në këtë kontekst, dua të vendos para duarve tuaja disa shembuj të përzgjedhur nga duatë e ndryshme të shumë prej të dërguarve të Allahut (xh. sh) në kohë të hershme dhe për shkaqe të ndryshme, si një mësim i urtë për secilin prej nesh, që të mos frenohemi kur është koha për t'u drejtuar nga Zoti ynë për çdo gjë në jetë! Ndoshta, ky është edhe një prej shkaqeve, që i Drëguari i Allahut (a.s), i udhëzonte sahabët e tij, që për çdo situatë, të drejtoheshin nga dyert e lutjes: "Resulullahu (paqja e Allahut qoftë mbi të) na mësonte istiharen (namazin me lutjen për qartësimin e përzgjedhjes në jetë) në të gjitha çështjet, njësoj siç na mësonte suret e Kuranit...".[7]

Hz. Ademi (a.s) dhe Nana e jonë Hava: "Ata thanë: 'O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit'...".[8]

Hz. Nuhu (a.s): "(Nuhu) tha: 'O Zoti im, më ndihmo, sepse ata më quajnë për gënjeshtar!'...".[9]

Poashtu përmendet duaja e tij (a.s) në një moment të thirrjes së tij

1. Kurani, Fatir: 15.
2. Kurani, Ali Imran: 186.
3. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ahmedi, nga Ebu Hurejra (r.a).
4. Transmetuar nga Taberaniu në Es-Sagir, nga Sad ibn Ebi Vekkas (r.a).
5. El-Alame Ebil-Kasim El-Kushejri, Er-Risaletul-Kushejrije, botimi i tretë, Darul-Khajr, Damask, 1997, f. 267.
6. Kurani, El-Bekare: 186.
7. Transmetuar nga Imam Bukhariu e të tjerë, nga Xhabir ibn Abdilah (r.a).
8. Kurani, El-Araf: 23
9. Kurani, El-Muminun: 26.



MESAZH URIMI

Urim me rastin e Krishtlindjes
Drejtuar: Mons. Angelo Massafra, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult
I nderuar, z. Arqipeshkëv,

Në kushtet e padëshiruara të kufizimeve për shkak të Covid-19, jam i detyruar t'ju përcjell këtë urim të përzemërt nëpërmjet kësaj shkrese, edhe pse dëshira ishte që të takoheshim nga afër.

Ditët dhe ngjarjet e shënuara festive të kalendareve tona fetare janë momente reflektimi që na ftojnë të hedhim sytë përreth për të parë dhe për të gjetur shkëndija drite pas të cilave të kapemi, e së bashku të ndërtojmë modele dhe shembuj elitarë për shoqërinë, kombin dhe mbarë njerëzimin.

Realitetet e sotme shqiptare dhe ato të botës mbarë po e tërheqin njeriun përherë e më tepër drejt besimit, strehës së tij, dashnisë së Zotit dhe udhëzimit të Lajmëtarëve të Tij.

Vula e të Dërguarve, Hz. Muhammedi (paqja e Zotit qoftë përmbi të), në mëson se: "Më i miri i njerëzve është më i dobishmi i tyre për ta".

Po ashtu, më herët vëllai i tij, Jezusi (paqja e Zotit qoftë përmbi të), lutej botërisht: "Zoti im fali, se s'dinë çfarë bëjnë".

Nga ky taban dhe ky cak i shenjtë, na del për detyrë që dorë për dore, të krishterë dhe muslimanë, të kapemi fort pas mësimeve dhe udhëzimeve të Zotit, të punojmë me sa të kemi mundësi për të ruajtur njeriun e kësaj nga kohe nga rrëshqitja dhe devijimi i mëtejshëm në afetarizëm, shthurje, imoralitet dhe padije.

Mesazhet e forta plot urtësi dhe largpamësi të Imamit të Madh, Shejkhul-Ez'herit, Ahmed Et-Tajib dhe Sh.T. Papa Françeskut, janë një argument më shumë nga Zoti për ne, që të shfrytëzojmë kohën dhe të shtrëngojmë duart për të mirën e njerëzimit dhe përhapjen e vlerave të vëllazërisë dhe bashkëpunimit të sinqertë, që përkthehet në siguri dhe garanci për jetën e njeriut në tokë, të sotmen dhe të ardhmen e tij.

Gëzuar, me lutjet e mia më të përzemërta për ju, komunitetin tuaj besimtar, Shkodrën tonë të dashur, Shqipërinë e shtrenjtë dhe mbarë njerëzimin.

Me respekt:

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

MYFTIU NGUSHËLLOI FAMILJARËT E IMAMIT TË NDERUAR, H. VESEL CURRAJ

Paraditën e së hënës, më 27 dhjetor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, ishte për vizitë ngushëllimi tek familja e rahmetliut, H. Vesel Sejdi Curraj, imam dhe aktivist i shquar i Malësisë së Madhe.

H. Vesel Curraj, i datëlindjes 1930, ka shërbyer si imam i xhamisë së fshatit së vendlindjes së tij Linaj, nga viti 1991 e deri në vitin 2005; e dyta xhami e rihapur në rang republike, pas xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990.

Ai ishte aktivist i zellshëm për ringritjen e xhamive në zonën e Malësisë së Madhe, duke kontribuar edhe personalisht me pasurinë e mundësitë e familjes së tij.

Në ngushëllimet e shprehura familjes, Myftiu Sytari u shpreh se brezi i imamëve dhe veprimtarëve të pas '90, mbetet shembull i sakrificës, përkushtimit dhe dashurisë për besimin, fenë islame dhe harmoninë kombëtare.

Ai u lut për shpirtin e imamit rahmetli dhe mbarësinë e trashëgimtarëve të tij.

dhe kundërshtive të forta të popullit të tij idhujtar: “Dhe Nuhu tha: ‘O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë femohues, sepse, nëse Ti i lë, ata do t’i shpien në humbje robërit e Tu dhe do të lindin vetëm kriminelë dhe jobesimtarë! O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time! Fali të gjithë besimtarët e besimtaret, ndërsa keqbërësve shtoju vetëm shkatërrim!’...”.[10]

Hz. Junusi (a.s): “(Kujtoje) Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar e mendoi se Ne nuk do ta dënojmë, andaj thërriti nga errësira: ‘S’ka zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!’...”.[11]

Hz. Ibrahimi (a.s): “Kur Ibrahimi u lut: ‘Zoti Im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!’ - Allahu tha: ‘Atë që nuk beson, për pak kohë do ta bëj që të kënaqet e pastaj do ta hedh në dënimin e zjarrit.’ Eh, sa vendbanim i keq që është ai!”.[12]

Hz. Ibrahimi (a.s) dhe i biri, Hz. Ismaili (a.s): “Kur Ibrahimi dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes, u lutën: ‘O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka! O Zoti ynë! Na bëj të përulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti! O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u lexojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë (rregullat e fesë) e t’i pastrojë (nga gjynahet)! Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!’...”.[13]

Hz. Luti (a.s): “Ai tha: ‘O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën mbrapshti’!”.[14]

Për këtë, Resulullahu thoshte: “E mëshiroftë Allahu Lutin, ai ishte mbështeur tek një shtyllë e fortë!”[15], që nënkupton mbështetjen e tij në Allahun e Madhëruar dhe lutjen e tij drejtuar Zotit të gjithësisë për ta shpëtuar nga zullumet e popullit të tij.

Hz. Zekerija (a.s): “Atëherë Zekerija iu lut Zotit të vet e tha: ‘Zoti im! Dhuromë nga ana Jote një pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!’...”.[16]

Hz. Sulejmani (a.s): “Ne e vumë në provë Sulejmanin dhe vendosëm në fronin e tij një trup, por ai iu drejtua Zotit dhe tha: ‘O Zoti im, më fal dhe më dhuro një pushtet që të mos e ketë askush pas meje! Me të vërtetë, Ti je Dhurues i madh!’. Pastaj, Ne ia nënshtruam atij erën që të frynte me urdhrin e tij, andej nga të donte ai...”.[17]

Poashtu në Kuran është regjistruar edhe lutja e tij (a.s), në momentin kur dëgjoi milingonën duke dhënë kushtrimin e saj: “Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: ‘O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë’!”[18] Këtu, Hz. Sulejmani (a.s) iu drejtua Allahut të Madhëruar me një lutje falënderimi, që është përjetësuar në Shpalljen hyjnore: “Ai vuri buzën në gaz, duke qeshur me fjalët e saj dhe tha: ‘O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!’...”.[19]

Kanë thënë: “Kjo është prej duave më gjithpërfshirëse dhe prej më të përshtatshmeve për gjendjen e tij (a.s) duke parë dhuntitë e Allahut (xh. sh), prej mbretërisë madhështore dhe mirësisë së dukshme”.[20]

Hz. Shuajbi (a.s): “Paria arrogante e popullit të tij tha: ‘O Shuajb! Kthehuni në fenë tonë ose do t’ju dëbojmë nga qyteti ynë ty me gjithë ndjekësit e tu’. Shuajbi tha: ‘Edhe pse e urrejmë atë?! Nëse do të kthehesim në fenë tuaj, pasi Allahu na shpëtoi nga ajo, atëherë do të shpifnim gënjeshtra kundër Allahut. Ne nuk mund të kthehemi në të, përveçse po të dojë Allahu, Zoti ynë. Ai përfshin çdo gjë me dijeninë e Vet dhe tek Ai ne mbështetemi. O Zoti ynë, gjyko drejt midis nesh dhe popullit tonë! Ti je Gjykatësi më i mirë’...”.[21]

Hz. Jusufi (a.s): “Ai tha: ‘O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).’...”.[22]

Hz. Musa (a.s): “Kështu, Musai u dha

10. Kurani, Nuh: 26-28.
11. Kurani, El-Enbija: 87.
12. Kurani, El-Bekare: 126.
13. Kurani, El-Bekare: 127-129.
14. Kurani, El-Ankebut: 30.
15. Transmetuar nga Imam Buhariu, nga Ebu Hurejra (r.a).
16. Kurani, Ali Imran: 38.
17. Kurani, Sad: 34-36.
18. Kurani, En-Neml: 18.
19. Kurani, En-Neml: 19.
20. Abdurrezak ibn Abdelmuhsin El-Bedr, Fikhul-ed’ijeti vel-edhkar, botimi i parë, Mektebetu Daril-Minhaxh, Rijad, 1434 h., f. 836.
21. Kurani, El-Araf: 88-89.
22. Kurani, Jusuf: 33.



Në librat e shumtë të haditheve, mësojmë me qindra lutje, të transmetuara nga i Dërguari i Allahut, si një mundësi më shumë për të mësuar se si t’i drejtohemi Zotit tonë, por edhe si një udhëzues praktik, që në mëson mbi të gjitha shpirtin e lutjes dhe na frymëzon drejt mos ndarjes nga kjo mirësi, dera e së cilës nuk na mbyllet asnjëherë në jetë!

ujë kafshëve të tyre e pastaj u kthye te një hije dhe tha: ‘Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!’...”.[23]

Hz. Isa (a.s): “O Allah, o Zoti ynë! – tha Isai, i biri i Merjemes – Zbritna një sofër nga qielli, që të jetë festë për ne, për të parin dhe të fundmin tonë dhe të jetë mrekulli prej Teje dhe na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i mirë!”.[24]

Është për t’u theksuar se të gjithë të dërguarit të përmenden në Kuran, edhe me luitjet e tyre, na dëshmohen me mënyrat se si i janë drejtuar Zotit, me përjashtim të Hz. Muhamedit (a.s), të cilin e mëson Vetë Allahu i Madhëruar se si e çfarë të lutet, si për shembull: “Thuaj (o Muhamed): ‘O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe që dita të hyjë tek nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij.’...”.[25]

Poashtu, spikat edhe lutja e melekëve (a.s): “Ata (melekët), që e mbajnë Fronin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët, duke thënë: ‘O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakërues! O Zoti ynë, shpjeri ata në kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar, së bashku me të devotshmit prej prindërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe pasardhësve të tyre! Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti. Dhe shpëtoji ata nga e keqja! Atë që Ti e shpëton nga e keqja atë Ditë, Ti e ke mëshiruar; e ky, me të vërtetë, është shpëtimi i madh!’..”.[26]

Në librat e shumtë të haditheve, mësojmë me qindra lutje, të transmetuara nga i Dërguari i Allahut, si një mundësi më shumë për të mësuar se si t’i drejtohemi Zotit tonë, por edhe si një udhëzues praktik, që në mëson mbi të gjitha shpirtin e lutjes dhe na frymëzon drejt mos ndarjes nga kjo mirësi, dera e së cilës nuk na mbyllet asnjëherë në jetë!

23. Kurani, El-Kasas: 24.
24. Kurani, El-Maide: 114.
25. Kurani, Ali Imran: 26-27.
26. Kurani, Gafir: 7-9.

ALLAHU MË NXORI NGA FAMILJA DHE MË SOLLI TEK TI, PËR TË KRYER HALLIN TËND...



Shejkh Ali Et-Tantavi (r.h) tregon:

Një herë, më i madhi i familjes sonë, Dr. Tahir Et-Tantavi, Allahu e mëshiroftë, na ftoi për t’u bërë gjithë bashkë, tërë anëtarët e familjes.

Kishte përgatitur një darkë me të gjithë të mirat, me ushqime të shijshme e të këndshme.

Kishte përgatitur gjithçka, që t’i kënaqte dhe t’i gëzonte të gjithë.

Shkova në këtë tubim me zemër të kënaqur.

Nuk qëndrova, veçse gjysmë ore, derisa mu ngushtua gjoksi dhe ndjeva, sikur diçka po më shtynte të dilja jashtë dhe, nëse unë do të qëndroja, do të m’u zinte fryma! U kërkova leje për t’u larguar, por u habitën prej meje!!

Edhe unë po habitesha me veten time, e nuk e dija, se çfarë më gjeti!

U prish ndeja dhe humbi gjithë ajo, që kishin pritur të gjenin prej kënaqësisë dhe lezetit.

Të gjithë ma hodhën fajin mua, e unë u kërkoja falje dhe ndërkohë nuk e dija se përse po veproja kështu!!

Shtëpia e tij ndodhej rrëzë malit Kasijun, në një zonë të quajtur lagja El-Afif. Dola.. aty pari kaloi furgoni, që ishte bosh. Desha të hipi në të, por pastaj m’u duk se një dorë e fortë po më pengonte për të hipur.

Kështu, që eca në këmbë dhe nuk po dija se ku isha duke shkuar...

Më besoni, që po jua përshkruaj çfarë më ndodhi, sikur të më kishte ndodhur dje, ndërkohë që ajo më ka ndodhur para më shumë se 30 viteve.

Nuk eca, veçse pak... rruga ishte vështirë dhe nata ishte e qetë.

Takova një grua, e cila mbante një fëmijë në krah dhe një tjetër e tërhiqte për dore.

Ajo rënkonte dhe qante, e lutej me zë të ulët, saqë nuk e kuptoja.

Iu afrova dhe e pyeta: Çfarë ke, o motër?

M’u largua dhe mendoi, se mos kisha ndonjë qëllim të keq.

Më vështroi dhe pasi më pa se isha i moshuar dhe se nuk kishe pse të frikësohej prej meje, e hapi zemrën dhe më shpjegoi hallin saj.

Allahu t’i është përgjigjur lutjes tënde, o ti grua; sepse ty të është bërë zullum dhe lutja e atij që i është bërë zullum, mes saj dhe mes Allahut nuk ka perde. E, unë jam gjykatësi! Allahu më nxori nga familja ime dhe më solli tek ti për të kryer hallin tënd, inshallah.

Kjo është historia e saj:

Ajo ishte nga Halebi. Burri i saj ishte nëpunës në Damask dhe e kishte nxjerrë (dëbuar) nga shtëpia, e ajo nuk dinte ku të shkonte. Ajo nuk kishte njeri, përveç një daje, dhe nuk po arrinte t’ia gjente shtëpinë e tij.

I thashë: Unë të çoj tek shtëpia e dajës tënd dhe, nesër shko në gjykatë e denonco tek gjykatësi ankesën tënde.

Ajo filloi të qante edhe më shumë dhe tha: Si mund të shkoj tek gjykatësi, ndërkohë që unë jam një grua e mjerë dhe gjykatësi nuk pret njerëz si puna ime, e as që i dëgjon ata?!

Atëkohë, unë isha gjykatës i Damaskut.

I thashë: Allahu t’i është përgjigjur lutjes tënde, o ti grua; sepse ty të është bërë zullum dhe lutja e atij që i është bërë zullum, mes saj dhe mes Allahut nuk ka perde. E, unë jam gjykatësi! Allahu më nxori nga familja ime dhe më solli tek ti për të kryer hallin tënd, inshallah.

Kjo është kartëvizita ime. Nesër eja te gjykata dhe më tako.

Ali Et-Tantavi,nga libri Nurun ve hidaje” (Dritë dhe udhëzim)

SA E RËNDËSISHME ËSHTË TË INVESTOSH NË VETEN TËNDE?

Sot, shumë njerëz në mbarë botën, janë të motivuar nga ana financiare duke treguar shumë kujdes në investimin e pasurisë së tyre. Ata zgjedhin të investojnë pasuritë për të përfituar nga ky investim në një kohë të mëvonshme, në mënyrë që të sigurojnë jetesën dhe të ardhmen e tyre. Por feja islame jo vetëm që e vlerëson investimin në ekonomi, por shkon përtej perspektivës materialiste. Ajo ka si qëllim, jo vetëm arritjen e mirëqenies materiale, por edhe arritjen e mirëqenies mendore dhe shpirtërore. Prandaj tregon kujdes jo vetëm në aspektin material, por shtrihet më tej, në kërkesat e mendjes e të shpirtit, të cilat nuk janë më pak të rëndësishme në jetën tonë se ato materiale. Në këtë shkrim do flasim për konceptin gjithëpërfshirës të investimit në jetën e muslimanit, duke mos u ndalur në investimin material, por në rëndësinë e investimit individual tek vetja jonë, veçanërisht në aspektin shpirtëror, mendor dhe emocional.

"Përfito nga pesë gjëra para pesë të tjerave: nga jeta para vdekjes, nga shëndeti para sëmundjes, nga boshllëku para angazhimit, nga rinia para pleqërisë dhe nga pasuria para varfërisë."

Ç' KUPTOJMË ME TERMIN "INVESTIM NË VETE"?

Me termin "investim" kuptojmë rritjen, zhvillimin, shfrytëzimin e energjive dhe të potencialeve në dispozicion të qenies njerëzore dhe punësimin optimal të tyre.

Për këtë i Dërguari i Allahut këshilloi një burrë duke i thënë: "Përfito nga pesë gjëra para pesë të tjerave: nga jeta para vdekjes, nga shëndeti para sëmundjes, nga boshllëku para angazhimit, nga rinia para pleqërisë dhe nga pasuria para varfërisë." [1]

Ky hadith na tregon më së miri, se investimi në jetën e njeriut përmbledh shumë fusha, jo vetëm atë ekonomike, por edhe atë shëndetësore, kohore, shpirtërore, etj.

PSE KA RËNDËSI INVESTIMI NË VETE?

Rëndësinë e investimit në vete e kuptojmë nga ajeti kur'anor, në të cilin Allahu (xh.sh) thotë:

"Faleni namazin dhe jepeni zekatin! Çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Në të vërtetë Ai sheh mirë gjithçka që bëni." [2]

Tani, le të ndalemi pak, për ta analizuar këtë ajet!

Fjalia: "Çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj" (për veten tuaj) do të thotë, se çfarëdo të mire të investosh për veten tënde, ajo do të kthehet ty, sepse atë do ta gjesh tek Allahu".

Po ta krahasojmë këtë me një investimin material, do vëmë re se, kur dikush vendos para në një biznes, fitimin nuk e merr menjëherë, por e merr pas një kohe të caktuar. Që do të thotë se këto para do t'i kthehen ndoshta pas disa muajsh, apo pas disa vitesh, por për shkaqe nga më të ndryshmet, mund të ketë gjasa që fitimi të mos i kthehet fare.

Prandaj Allahu na porosit që të investojmë në veten tonë për mirë, jo vetëm materialisht, por duke e përmirësuar vazhdimisht veten, sepse përfitimet do të na rikthehen si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën. Dikush mund të ketë dëshirë të mësojë dhe të kuptoj Kuranin, apo diçka tjetër. Kështilla jonë është që të fillojë më parë me mësimin e disa sureve të shkurtra nga Kur'ani, sepse duhet të fillojë pak nga pak për të përmirësuar veten, pastaj do të shohë rezultatet!

Po në ajetin e mësipërm, Allahu (xh.sh) thotë "min hajrin" që do të thotë "çfarëdo të mire", çfarëdo lloj pune të mirë të investoni, që nënkupton se nuk duhet të nënvlerësoni asnjë gjë të mirë, sepse atë që keni mundësi ta bëni ju, ndoshta nuk e ka dikush tjetër. Sepse gjithsecili prej nesh ka mundësi të ndryshme, të cilat nuk mund t'i ketë dikush tjetër. Kur Allahu thotë "çfarëdo", ka si qëllim "llojshmëri të ndryshme mundësish dhe investimesh". Prandaj nuk duhet të nënvlerësoni asnjë mundësi, asnjë të mirë që mund t'i bëni vetes dhe komunitetit, sado të vogla të jenë apo sado të vogla të duken ato.

Në fund të ajetit Allahu (xh.sh) thotë: "Në të vërtetë Ai sheh mirë gjithçka që bëni", që do të thotë, se ne nuk duhet të keni asnjë dyshim, se çfarëdo lloj të mire të bëni, Allahu e sheh atë.

Por shpesh herë, jo vetëm që njerëzit nuk kujdesen të investojnë në veten e tyre apo tek njerëzit që i rrethojmë, por merren dhe harxhojnë kohë me atë që të tjerët investojnë. E në vend të përqendrohen tek ajo që ata bëjnë, që ata investojnë, përqendrohen tek ajo që të tjerët bëjnë, veçanërisht tek ata që s'kanë lidhje me besimin apo traditën Islame.

A keni pyetur veten ndonjëherë: "Çfarë kam investuar unë te vetja ime nga ana e besimit, gjatë këtyre viteve?", "Çfarë kam investuar te fëmijët, apo tek familja ime për këtë?", "Çfarë kam investuar te shoqëria apo te qyteti im?", "Cilat janë këto investime?", "Çfarë kam bërë për veten time, kur

Investimi në vete është një nga investimet më të mira që mund të bëjë njeriu, por në të vërtetë, është ndër gjërat që neglizhohet më së shumti.

Allahu (xh.sh) më ka ngarkuar me detyrën e "halifes"?!" ... Vallë, a mund të justifikohet gjendja jonë sot dhe e shumë muslimanëve në botë vetëm me thënien: "Çfarë të bëjmë, kështu ka qenë e shkruar" ose: "S'kemi asgjë në dorë!". A thua e kemi harruar ajetin kuranor, ku Allahu xh.sh thotë: "Me të vërtetë, Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete." [3]

SI MUND TË INVESTOJMË NË VETEN TONË?

Investimi në vete është një nga investimet më të mira që mund të bëjë njeriu, por në të vërtetë, është ndër gjërat që neglizhohet më së shumti. Myslimani nëse investon tek vetja e vet, në çfarëdo fushe, ai investim do t'i rikthehet dhe pa diskutim do të përfitojë prej tij. Në mënyrë të veçantë, nëse investon në një punë të mirë dhe përfitimet e saj do i marrë në këtë botë, por edhe në botën tjetër. Prandaj investimi në veten tonë nuk mund të jetë kurrë i padobishëm, ose një humbje kohe, por ai do na ndihmojë jo vetëm të jetojmë një jetë të mirë në këtë botë, por edhe të fitojmë botën tjetër në Ahiret. Kështu që, ne duhet të shqetësohemi të investojmë jo vetëm për këtë botë, por edhe për Ahiretin, për botën e amshuar, si për vete ashtu edhe për fëmijët tanë, e kështu me radhë. E ky investim dinamik fillon në nivelin individual në aspektin shpirtëror, mendor dhe atë emocional.



Për të investuar në veten tuaj, fillimisht duhet të mësoni të vendosni një qëllim personal të pastër në jetë, të zgjuar, specifik, afat gjatë, që është i matshëm dhe i realizueshëm në kohë. Pa pasur një qëllim të mirë, jo vetëm që nuk do të arrini vetë-përmirësimin, por edhe nuk do ta keni të qartë se cili është destinacioni juaj që dëshironi të mbërrini.

INVESTIMI NË ASPEKTIN SHPIRTËROR

Trupi i çdo njeriu përbëhet nga trupi dhe shpirti, prandaj siç kujdesemi për trupin, duhet të kujdesemi edhe për shpirtin. I Dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të, tha një herë: "Me të vërtetë unë jam dërguar (si Profet) të plotësoj përsosjen e karakterit njerëzor." [4] Ky hadith përcakton një aspekt shumë të rëndësishëm të Islamit, "vetë-përmirësimin" përmes pastrimit të cilësive personale të njeriut. Islami, si një besim dhe një mënyrë jetese, i mëson muslimanët të përqendrohen në përmirësimin e vetes, duke ndjekur Kuranin dhe mësimet e Profetit Muhammed (a.s.).

Ky investimi shpirtëror mund të arrihet me anë të: Qëllimit të mirë (nijetit).

Për të investuar në veten tuaj, fillimisht duhet të mësoni të vendosni një qëllim personal të pastër në jetë, të zgjuar, specifik, afat gjatë, që është i matshëm dhe i realizueshëm në kohë. Pa pasur një qëllim të mirë, jo vetëm që nuk do të arrini vetë-përmirësimin, por edhe nuk do ta keni të qartë se cili është destinacioni juaj që dëshironi të mbërrini. Prandaj duket treguar shumë kujdes në përcaktimin e qëllimit, e pastaj të filloni investimin tuaj shpirtëror. Profeti ynë (a.s.) ka thënë: "Veprat janë sipas qëllimit, e secili njeri do të shpërblehet sipas qëllimit të tij." [5]

TEZKIJE (PASTRIMI I ZEMRËS)

Pasi keni vendosur një qëllim të mirë, hapi i dytë në investimin shpirtëror, bëhet duke pastruar zemrën (me Tezkije), e cila është pastrimi i shpirtit dhe çlirimi i saj nga mëkati. Allahu xh.sh thotë: "Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe ua mëson Librin (Kuranin) e urtësinë, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar." [6] Duke u mbështetur në Kur'an dhe sunnet, tezkija (pastrimi i zemrës) mund të arrihet përmes ibadetit, adhurimit të një Zotit të vetëm e të pashoq, duke u thelluar në të kuptuarit e pesë shtyllave të Islamit dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Arrihet me anë të lutjeve të ndryshme, apo (edhkareve) të mëngjesit e të darkës, me të cilat jo vetëm që i afroheni më tepër Zotit, por arrini të zvogëloni edhe mundësitë e veprimit të ndonjë gjynahu. Arrihet përmes përmirësimit të sjelljes morale me kultivimin e sinqeritetit dhe të sjelljes së mirë. Gjithashtu arrihet duke menaxhuar sa më mirë kohën tonë, e duke qenë sa më produktivë; duke u dhënë ndihmë atyre që kanë nevojë; duke mbajtur një shoqëri të mirë dhe miq që ndikojnë pozitivisht; e duke mos lënë në harresë pendimin e sinqertë për gjynahet dhe kërkimin e mëshirës dhe faljes së Allahut (xh.sh).

Përfshirja e hapave të mësipërme në jetën tuaj të përditshme, me kalimin e kohës, do të përmirësojë shëndetin shpirtëror të zemrës suaj, sepse në Islam, zemra është qendra e rritjes shpirtërore.

INVESTIMI NË ASPEKTIN MENDOR

Për qeniet njerëzore, thelbësore, në jetën e kësaj bote është zhvillimi i mendjes, i zemrës dhe i shpirtit, duke u përpjekur për tu bërë një njeri më i mirë. E kjo gjë mund të arrihet vetëm me anë të arsyes dhe me anë të zbulesën hyjnore (shpalljes). Prandaj, Allahu i dha njeriut një mendje dhe një zemër, gjithashtu për t'i zhvilluar ata, i dërgoi profetë dhe fe.

Njeriu siç mund të zbresë në të keqe në esfeli safilin (shumë poshtë) në xhehennem, mund të arrijë me mirësi deri në il-lijin, (në nivelet më të larta) në Xhennet. Por e vetme arsyeja pa zbulesën hyjnore nuk mund t'i japë asgjë njeriut dhe njerëzimit. Sepse mendja është një mjet ashtu si syri. Sikurse syri është i padobishëm në errësirë, edhe mendja nuk mund ta shohë të vërtetën pa dritën e zbulesës hyjnore. Prandaj, nëse një person dëshiron të zhvillohet në mendje dhe në zemër, ai duhet të përpiqet të kuptojë Kur'anin dhe sunnetin (zbulesën e fundit hyjnore). Kur'ani i fton njerëzit të mendojnë dhe të meditojnë në mënyrë të vazhdueshme, gjë që i pëlqen mendjes dhe zemrës. Ai të bën të mendosh për veten, për universin, për popujt, për ngjarjet e kaluara ...

Në mënyrë që njeriu të zhvillohet mendërisht dhe shpirtërisht ai duhet:

Të lexojë dhe të kuptojë Kuranin! Në lidhje me këtë, Allahu thotë: "Ky Kuran, është tregues i qartë, udhërrëfyes dhe

1. Transmeton Hakimi, nga Ibn Abasi (r.a).
2. Kur'ani, El-Bekare: 110.
3. Kur'ani, Er-Ra'd: 11.
4. Transmeton Buhariu, El-Edebul-Mufred, Bejrut, 1997, f. 104.
5. Muttefekun alejhi.
6. Kur'ani, Al Imran: 164.

8

Ta lexojë veten si një univers i vogël, në mënyrë që t'i përgjigjet shumë pyetjeve! Si p.sh, kush jam unë? Pse jam krijuar? Cili do të jetë fundi im? Çfarë kërkon Krijuesi nga unë? Si duhet të përdori mendjen, zemrën dhe shqisat që më janë dhënë? Ku duhet t'i përdor ato?

mëshirë për njerëzit që kanë besim të patundur."[7] Prandaj, lexoni sa më shumë Kuran, por edhe libra të tjerë të dobishëm, sepse leximi i tyre zgjeron mendjen dhe është një investim i mirë për veten.

Të meditojë dhe të kërkojë rreth krijimit të Universit! Kush e ka krijuar atë, ku çdo gjë që shohim është në harmoni me njëra-tjetrën?! A mund të jetë kjo një rastësi?!

Ta lexojë veten si një univers i vogël, në mënyrë që t'i përgjigjet shumë pyetjeve! Si p.sh: Kush jam unë? Pse jam krijuar? Cili do të jetë fundi im? Çfarë kërkon Krijuesi nga unë? Si duhet të përdori mendjen, zemrën dhe shqisat që më janë dhënë? Ku duhet t'i përdor ato? Nëse njeriu mendon dhe arrin t'i përgjigjet pyetjeve të tilla, atëherë jeta e tij ka marrë kuptimin e duhur. Për këtë Allahu xh.sh thotë: "Në tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje. Po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?"[8]

INVESTIMI
NË ASPEKTIN EMOCIONAL

Për të investuar në aspektin emocional, jo vetëm që do kujdeseni për ato që u tha më sipër, por edhe për shumë gjëra të tjera. Këtu po përmendim tre gjëra, të cilat mendojmë se do të kenë ndikim pozitiv në investimin në aspektin emocional.

Reflektoni rreth veprimit që bëni, sepse reflektimi është jetik për ne. Nëse nuk reflektoni mbi veprimet dhe sjelljet tuaja, do të jetë shumë e vështirë t'i përmirësoni ato. Për shembull, nëse sapo keni folur me dikë, duke qenë të pakujdesshëm për atë që thoni, as që do ta kuptoni, nëse e keni lënduar personin tjetër apo jo.

Hiqni dorë nga zakonet e këqija! Të gjithë ne kemi zakone të këqija, por disa prej nesh shpërdorojnë kohën dhe paratë e tyre pa kriter, disa nuk ushqehen si duhen, e disa të tjerë hanë shumë... Në fillim duhet të kuptoni se cilat janë zakonet tuaja këqija, pastaj të mundoheni të hiqni dorë prej tyre gradualisht, në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht tek ju. Normalisht të ndryshosh një zakon të keq, nuk është aspak e lehtë sepse kërkohet shumë energji dhe vendosmëri. Por kur të arrini të zëvendësoni një zakon të keq me një të mirë, atëherë keni filluar të ndryshoni jetën tënde. Mund të lind pyetja, si mund të krijoj një zakon të mirë, çfarëdo qoftë ai? Gjëja e parë që duhet të keni parasysh është të dini se çfarë do të zgjedhni të bëni? Pastaj të merrni hapat e duhur për realizimin në jetë të asaj që dëshironi. P.sh nëse dëshironi të mësoni gjuhën arabe, më parë duhet të filloni të mësoni shkronjat e gjuhës arabe. Si fillim duhet të flisni me një mësues/e të duhur, që mund t'iu mësojë për këtë gjë. Pastaj do caktoni një orar, si p.sh. 30 minuta (të paktën) çdo ditë, apo 45 minuta, 3 herë në javë, etj. Duhet të filloni të punoni çdo ditë nga pak, e pas një kohe do vëreni rezultatet dhe vërtetë do habiteni se si arritët të bëni diçka që dikur ju është dukur e parealizueshme.

Bëni një listë detyrash, të cilat ia keni caktuar vetes, ku të shkruani të gjitha ato që dëshironi t'i realizoni apo t'i përjetoni në jetën tuaj. Edhe pse mund të shkruani 50 gjëra, rëndësi ka që të filloni me njërën prej tyre, e çdo muaj të paktën të fshihni njërën ose disa prej tyre.

Edhe pse këto gjëra mund të duken të parëndësishme, por duke investuar në vete dhe duke e bërë vazhdimisht këtë, do të arrini të shihni rezultate pozitive, të cilat as nuk do ju kishin shkuar aspak ndërmend më parë.

Lusim Allahun të na bëjë të mundur të investojnë në veten tonë, për këtë botë në të cilën jetojmë, dhe për botën tjetër, Ahiretin, të ardhmen tonë të vërtetë!

MSc. **Zamira Bushati (Puka)**
Vaize - Myftinia Shkodër

Sharuana Myselimi
Studente e Matematikës, Shkodër

7. Kur'ani, El-Xhathije: 20.
8. Kur'ani, Edh-Dharijat: 20-21.

SHKATËRRIMI I RIMËKËMBJEVE PËRMES NJERIUT GJYSMAK..!

Malik ibn Nebi
(1905 - 1973)

Njeriu gjysmak është ai njeriu i ashpër dhe këmbëngulës për të drejtat e tij, por ai nuk kryen as minimumin e detyrave të tij apo kulturës së mundshme aktuale!

Shkon në shkollë vetëm për të kaluar orët dhe interesi i tij më i madh është arritja e vlerësimit nga mësuesi apo lëndës së kërkuar në provim, pa pasur fare interes tek të mësuarit!

Shkon në punë dhe i kalon orët e punës në çfarëdolloj mënyre, e rëndësishme në fund të fundit të kalojë koha, t'i kthehet jetës së tij dhe të sigurojë jetesën!

Nuk mëson si duhet të mësojë një student, nuk punon si duhet të punojë një punëtorë, nuk shpik në punë, nuk zbulon ndonjë gjë në laborator dhe nuk përfundon asnjë projekt!

Ai në vazhdimësi është njeri gjysmak... kërkon të drejtat e tij, por nuk kryen detyrat e tij!"

Evans Drishti

S'KAM KOHË, SE MË DUHET TË DAL NË KAFE...

S'kam kohë, se më duhet të dal në kafe...

Agimi zbardh për të gjithë njëlloj...

Paradrekja, dreka, pasditja, mbrëmja...

E djeshmja, e sotmja, e nesërmja...

Sekondi, minuti, ora ...

Dita, java, muaji, viti...

Çdo gjë rrotullohet brenda 24 orëve...

24 orë ofrohen për çdo njeri njëlloj...

Por pesha e këtyre 24 orëve s'mund të jetë e njëjtë tek çdo njeri.

Besa dhe besëlidhja,

Zgjuarsia dhe mprehtësia,

Respekti ndaj vetes dhe tjetrit,

Respekti ndaj familjes si bërthama e shoqërisë,

Mikëpritja dhe dashamirësia,

Sinqeriteti dhe arsyetimi,

Guximi dhe këmbëngulja,

Urtësia dhe fjalëembëlsia,

Zemërgjerësia dhe ndihmesa,

Dashuria për të bukurën dhe finesa,

Burrëria dhe trimëria,

Vullneti dhe largpamësia,

Dituria dhe pjekuria...

Janë vetëm disa prej vlerave që na janë ushqyer për shekuj me radhë dhe që duhet ti ruajmë e ti mbrojmë si sytë e ballit.

Po si mundet vallë ti mbartim, ti përftojmë dhe ti trashëgojmë të tilla vlera?...

E thjeshtë!...

Të lexojmë, që të kuptojmë!...

Të lexojmë që të arsyetojmë!...

Të lexojmë që të gjykojmë!...

Të lexojmë që të reflektojmë!...

Të lexojmë që të jetojmë!...

Sepse,

Pa kuptuar s'mund të komunikojmë!...

Pa arsyetuar s'mund të veprojmë!...

Pa gjykuar s'mund të identifikojmë!...

Pa reflektuar s'mund të iniciojmë!...

Pa jetuar s'mund të ekzistojmë!...

Të gjithëve na është dhënë "koha" si pasuria më e virtytshme, së cilës akoma s'i është kuptuar "vlera" për të cilën jemi të detyruar dhe të obliguar "të ripërtërihemi" në dimensione të shumëanshme për të pranuar "pozicionin" tonë si "njerëz".

Impenjimet dhe angazhimet e njerëzve mbartin peshë vetëm mbi bazën e vizionit dhe perceptimit të tyre. Për rrjedhojë edhe "koha" përftohet dhe shfrytëzohet bazuar në qëllimin që ka individi.

S'kam kohë se me duhet të dal në kafe,

S'kam kohë se më duhet të takoj dikë

S'kam kohë se më duhet të shkoj të blej diçka

S'kam kohë se më presin

S'kam kohë se duhet të shkoj në ndeshje

S'kam kohë se duhet të shoh një film

S'kam kohë se më duhet të kryej punët e shtëpisë

S'kam kohë se do të luaj

S'kam kohë se më duhet t'u kthej përgjigje dhjetëra mesazheve në telefon

S'kam kohë se më ikën orari ...

Përqendrohuni ju lutem!...

Kuptoni veprimin që do bëni dhe synoni të arrini rezultatin!

Rezultatet që përftoni ju sjellin edhe arritjen që kërkoni për të qenë "njeriu i duhur në kohën e duhur".

Çdo gjë vjen nga një "lexim" i qartë i vetes dhe i asaj që kërkoni të arrini.

Kështu:

Kur ju prishet makina dhe shkoni te mjeshtri për ta rregulluar "prisni" me padurim një përgjigje të qartë dhe një rezultat pozitiv që makina të rikthehet si më parë. Kështu mjeshtri për ju është heroi i ditës dhe i kohës.

Kur shkoni te dentisti për mënjanimin e dhembjeve të shumta që ndjeni tek dhëmbët dhe përftoni rezultatin e duhur duke siguruar dhëmbë të shëndetshëm, arrini qetësinë e shumëpritur. Kështu dentisti për ju bëhet heroi i ditës dhe i kohës.

Kur kërkoni një mësues profesionist që t'ju plotësojë boshllëqet që ka fëmija juaj në një lëndë të caktuar dhe arrini rezultatin me notat e larta të shumëkërkuara, përjetoni mbresa të shkëlqyera. Kështu mësimdhënësi bëhet për ju heroi i ditës dhe i kohës.

Kur shkoni në një restorant që të provoni gatime të shijshme dhe cilësore mbeteni të kënaqur nga dora e artë e kuzhinierit. Kështu kuzhinieri bëhet për ju heroi i ditës dhe i kohës.

Kur kërkoni një mik të mirë që t'ju qëndrojë afër në momentet më të vështira dhe t'u ofrojë zgjidhje të duhura, personi që gjeni mbetet për ju heroi i ditës dhe i kohës. ...

Kush është heroi juaj i ditës dhe i kohës!?

Ka ardhur koha që "kafenetë" si ambientet më të frekuentueshme t'i kthejmë edhe në "ambiente leximi" të shoqëruara patjetër me një kafe apo çaj të ngrohtë!...



GAMBIA
OSE REPUBLIKA E GAMBIAS

Gambia, ose zyrtarisht Republika e Gambias, është një vend në Afrikën Perëndimore, i vendosur në bregun e Atlantikut. Ky është shteti më i vogël brenda Afrikës kontinentale, dhe është i rrethuar nga Senegali në tri anët e saj, me përjashtim të bregut perëndimor i cili laget nga Oqeani Atlantik. Shteti i Gambias ndodhet në të dy anët e rrjedhës së poshtme të lumit Gambia. Toka e tij është e rrafshët dhe mbizotërohet nga lumi, i cili është i lundrueshëm në të gjithë gjatësinë e vendit. Kufijtë aktualë të Gambias u përcaktuan në vitin 1889, pas një marrëveshjeje midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës.

Gambia e ka sipërfaqen 11.295 km^2 , dhe ka një populli prej 2.519.194 banorësh (sipas worldometers.info, dhjetor, 2021).

Benxhul është kryeqyteti i Gambias, dhe zona më e madhe metropolitane e vendit.

Gambia përmban tre eko-rajone tokësore: Savana pyjore Guinea, savana e Sudanit Perëndimor, dhe rizoforet Guinea. Topografia e Gambias nuk është shumë e ndryshme nga ajo e Senegalit, dhe përgjithësisht konsiderohet një fushë e gjatë që shtrihet në të dy anët e lumit, me klimë tropikale dhe të nxehtë, ashpërsinë e së cilës e zbut vetëm oqeani dhe lumi. Lumi Gambia është i vetmi burim natyror në vend, dhe në brigjet e tij ndodhen pak fshatra, të vendosur larg kënetave të lëna nga lumi. Toka bujqësore atje është ranore, e varfër, që mundëson prodhimin e kikirikut, ndërkohë që tokat kënetore përdoren për kultivimin e orizit. Në tokat e ulëta që vijojnë, rriten barërat e egra, dhe këto toka vazhdojnë me skajet e sipërme të luginës, të cilat përbëhen nga gurë ranorë, mbi të cilët rriten pemët natyrore. Pylli në të cilin rriten drurët Mahogany, alternohet me tokat bujqësore që vuajnë nga problemi i kripëzimit, gjë e cila diktoi prerjen e pemëve të pyllit për rikuperimin e atyre tokave dhe shfrytëzimin e tyre për bujqësi. Kjo solli zhdukjen e rreth 90% të pyllit natyror, gjë e cila u reflektua drejtpërdrejt në jetën e egër.

KLIMA

Gambia ka një klimë tropikale. Sezoni i nxehtë dhe me shi zakonisht zgjat nga qershori deri në tetor. Periudha e ftohtë e dimrit zgjat nga nëntori deri në maj, dhe erërat e thata (haramtan) fryjnë në këtë periudhë nga shkretëtira, duke ngritur pluhur dhe rërë në ajër; sezoni i dimrit atje ka më pak reshje. Temperatura mesatare gjatë sezonit të dimrit është 16 °C.

Reshjet vjetore në vend variojnë nga 650-1300 mm.

EKONOMIA

Gambia ka një ekonomi liberale, të bazuar në treg, e karakterizuar nga bujqësia tradicionale, e mbështetur historikisht tek prodhimi i kikirikut, që kryesisht eksportohet.



Bujqësia përbën afërsisht 30% të produktit të brendshëm bruto (PBB) dhe punëson rreth 70% të fuqisë punëtore. Brenda bujqësisë, prodhimi i kikirikut përbën 6.9% të PBB-së, kurse kulturat e tjera përbëjnë 8.3% të PBB-së, blegtoria 5.3%, peshkimi 1.8% dhe pylltaria 0.5%. Industria përbën rreth 8% të PBB-së dhe shërbimet rreth 58%. Masa e kufizuar e industrisë përpunuese është e bazuar kryesisht në prodhimet bujqësore dhe blegtorale (p.sh. përpunimi i kikirikut, fabrika e brumërave, një fabrikë lëkurësh, etj). Aktivitete të tjera industriale përfshijnë prodhimin e sapunit, të pijeve joalkoolike dhe të veshmbathjeve.

Më parë, Mbretëria e Bashkuar dhe BE-ja përbënin tregjet kryesore të eksportit të Gambias. Megjithatë, vitet e fundit Senegali, Shtetet e Bashkuara dhe Japonia janë bërë partnerë të rëndësishëm tregtarë të Gambias. Që nga viti 2017, Kina ka investuar në Gambia, si pjesë e nismës së saj "Belt and Road Initiative".

GJUHA

Anglishtja është gjuha zyrtare në Gambia, por gjuhët më të folura atje janë përgjithësisht ato të familjes Niger-Kongo, ato të degës së Atlantikut. Mandinka dhe Wolof janë gjuhët "lingua franka" (gjuhë që njihen nga të gjithë) të vendit, kurse gjuhët e tjera të folura përfshijnë ato Pular (Fulbe), Serer, Diola dhe Soninke. Një pjesë e klerikëve myslimanë njohin mirë gjuhën Arabe.

FEJA

Islami është feja mbizotëruese në Gambia, me rreth 90% të popullsisë që e ndjekin atë. Neni 25 i Kushtetutës së Gambias mbron të drejtën e qytetarëve të saj për të praktikuar çdo fe që ata zgjedhin. Me 12 Dhjetor të vitit 2015,

Presidenti i Gambias e shpalli Islamin fenë zyrtare të shtetit. Shumica e muslimanëve të Gambisë ndjekin shkollën sunite, dhe i përkasin shkollës së jurisprudencës Maliki.

Sa i përket komunitetit të krishterë, ata përfaqësojnë rreth 8% të popullsisë, dhe jetojnë në pjesët perëndimore dhe jugore të Gambias; shumica e tyre ndjekin Kishën Katolike. Pjesa tjetër e popullsisë, rreth 2%, ndjekin fetë autoktone afrikane.

HISTORI

Historia e Gambias para ardhjes së evropianëve atje, është ruajtur kryesisht nëpërmjet transmetimeve gojore, dhe është e lidhur ngushtë me atë të Senegalit fqinj.

Historia moderne e Gambias fillon me ardhjen e evropianëve atje, në mesin e shekullit të 15-të pas Isait (a.s). Eksploruesit portugezë mbërritën atje në vitin 1455 pas Isait (a.s), dhe krijuan qendra tregtare përgjatë lumit Gambia. Në shekullin e 17-të, kompanitë franceze dhe britanike i dëbuan portugezët nga Gambia, dhe në vitin 1816, Britania bleu Ishullin e vogël Banxhul, që i përkiste njërit prej sundimtarëve lokalë, dhe themeloi qytetin Batrest (tani Banxhul). Pavarësisht rezistencës së popullsisë vendase, Britania mundi të zgjerohej në brendësi të vendit, dhe arriti deri në pjesët e sipërme të lumit Gambia. Në vitin 1889, Britania dhe Franca ranë dakord dhe vendosën kufijtë aktualë të Gambias, brenda shtetit të Senegalit. Në vitin 1894 Gambia u bë një protektorat britanik, dhe në vitet në vijim britanikët e sunduan Gambian nëpërmjet sundimtarëve lokalë.

Gambia mbeti nën administrimin e drejtpërdrejtë britanik deri në vitin 1945. Pas Luftës së Dytë Botërore, banorët e Gambias filluan të kërkonin të drejtat e tyre afrikane. Pasi u bë i qartë karakteri afrikan i intelektualëve gambianë, Britania filloi të zbehte ndikimin e saj në menaxhimin e vendit, kështu që Gambia filloi të ngjiste shkallët e qytetërimit. Vendasit filluan të interesohen për arsimim, dhe Britania e inkurajoi këtë lëvizje të tyre, me qëllim trajnimin e kuadrove administrative për drejtimin e vendit. Numri i shkollave fillore u rrit nga gjashtë në vitin 1940, në 37, në vitin 1960. Kujdesi shëndetësor u zhvillua me rritjen e numrit të qendrave shëndetësore dhe të numrit të mjekëve. Partitë e para politike, që filluan të shfaqen nga viti 1950, e reduktuan pushtetin e presidentëve në favor të qytetarit të thjeshtë.

Gambia u bë e pavarur më 18 shkurt 1965, dhe u bë gjithashtu anëtare e Lidhjes së Kombeve Britanike (Komonuelthit). Daud Xhavara, i Partisë Progresive Popullore, zuri vendin e kryeministrit në krye të një sistemi demokratik, që zbatonte pluralizmin.

Në vitin 1970 u mbajt një referendum popullor, sipas të cilit Gambia u bë republikë, ku postin e presidentit e mori Xhavara. Një përpjekje e dështuar për grusht shteti në vitin 1981, rezultoi në formimin e një bashkimi midis Senegalit dhe Gambias në vitin 1982, që u quajt "Singambia". Presidenti senegalez, Abdu Daiuf, u bë president i shtetit të bashkuar, dhe Xhavara u bë zëvendës president. Në vitin 1989, bashkimi me Senegalin u rrëzua, dhe Xhavara u kthye sërish president i Gambias. Në vitin 1991, të dy vendet nënshkruan një traktat miqësie dhe bashkëpunimi.

Në vitin 1994, ushtria e përmbysi qeverinë Xhavara me një grusht shteti, pa gjak, dhe në vitin 1996 u ratifikua një kushtetutë e re, në të cilën u shpall sundimi i ligjit civil në vend, sipas së cilës presidenti zgjidhej për një mandat pesëvjeçar. Kjo kushtetutë u zbatua në Janar të vitit 1997.

SI ERDHI ISLAMI NË GAMBIA

Hyrja e Islamit në Gambia është e lidhur ngushtë me hyrjen e Islamit në Afrikën Perëndimore.

Fillimet e përhapjes së Islamit në Afrikën Perëndimore, siç e kemi përmendur edhe më parë, ishin falë shpërnguljeve të fiseve arabe dhe fiseve berbere që migruan në Afrikën Perëndimore - veçanërisht fiset Beni Hilal dhe Beni Selim - dhe që shtrinë ndikimin e tyre atje. Më pas, fise të tjera vendase që e pranuan Islamin, si fisi Xhudale, u zhvendosën në jug, kaluan lumin Niger, dhe morën rrugën për në Sudanin Perëndimor. Këto fise përfaqësonin hallkën lidhëse mes popujve të Marokut dhe kulturës së tyre, dhe rajonit të Afrikës perëndimore, i cili shtrihet deri në liqenin Çad. Shteti Almoravid me themeluesin e tij, Abdullah ibn Jasin, pati rolin kryesor në bashkimin e shkretëtirës, në Magribin e Largët. Ndikimi i tij u shtri nga Tunizia, deri në Oqeanin Atlantik në perëndim... nga Deti Mesdhe në veri, e deri në kufijtë me Sudanin në jug. Ky shtet kishte një flotë të madhe që kontrollonte ujërat e Mesdheut, dhe ishte ky shtet - që falë mirësisë së Zotit të Madhërishëm ndaj Islamit dhe muslimanëve - e vonoi

12

rënien e shtetit islam në Andaluzi, përgjatë katër shekujve. Shteti Almoravid u ndërtua mbi tri parime kryesore: 1 - Konsolidimi dhe forcimi i parimeve të besimit në shpirtrat e njerëzve. 2 - Zbatimi i mësimeve islame, në përputhje me atë çfarë është përcjellë nga Tradita Profetike 3 - Kthimi i Ligjit Fetar dhe atij Civil në doktrinën e Imam Malikut, gjë e cila do të ishte me e përshtatshme për qytetërimin islam dhe shoqërinë atje, dhe për të krijuar një ndjenjë të përbashkët fetare midis fiseve të shkretëtirës.

Shteti Almoravid bëri përpjekje të mëdha për përhapjen e Islamit, dhe këtë e kishte synimin e tij parësor. Almoravidët lanë gjurmë të thella në kulturën dhe qytetërimin e Afrikës Perëndimore, dhe një nga monumentet më të mëdha të epokës së tyre ishte themelimi i qytetit Timbuktu, në fund të shekullit të 5-të hixhrij, i cili u bë metropoli më i madh islam në Afrikën Perëndimore. Që nga fillimet e shekullit të 4-të e deri në shekullin e 11-të hixhrij, Mbretëria e Ganës u shndërrua në një mbretëri islame me një qytetërim të begatë. Ndikimi i këtij shteti islam shtrihej deri në veri të Nigerit të Sipërm, e në veriperëndim të tij. Kufijtë lindorë të këtij shteti ishin lumi Niger, kufijtë perëndimorë të tij ishin lumi i Senegalit, kurse ata veriorë ishin Shkretëtira.

Kur Mbretëria Islame e Ganës mori fund, në gjurmët e saj u ngrit Mbretëria e Malit (shek. 13- 15). Më i famshmi nga mbretërit e kësaj mbretërie ishte Mansa Musa, i cili udhëtoi për të bërë Haxhin në Shtëpinë e Shenjtë të Zotit, në Qaben e Bekuar, ndërkohë që me vete kishte një karvan të përbërë nga pasuesit e tij, shoqëruesit dhe shërbëtorët e tij, të llogaritur në qindra. Ata kaluan nga Kajro-ja, në vitin 724 hixhrij (1324 e.j), ku sulltani i saj, mbreti fitimtar, Muhamed ibn Kalaun, e priti dhe e nderoi në kështjellën e tij, së bashku me ndjekësit e tij.

Hasen ibn El-Vazin shkruante duke përshkruar jetën në kala, në Timbuktu, dhe thoshte se ajo përfshinte një numër të madh gjykatësish, mjekësh, dijetarësh fetarë, të cilët të gjithë gëzonin rroga të mira, të paguara nga mbreti, dhe se në vend kishte një kërkesë të madhe për libra të kopjuar që vinin nga Afrika e Veriut, dhe se tregtarët e librave fitonin më shumë se tregtarët e çdo zanati tjetër në treg. Eksploruesi Ibn Bat'tuta gjithashtu, e vizitoi këtë mbretëri, dhe përshkroi prosperitetin, tregtinë, industrinë, dhe të gjitha aspektet e jetës.

Pastaj mbi rrënojat e Mbretërisë Islame të Malit, u themelua Mbretëria Islame Songai (shek. 15- 17 e.j). Themelimi i saj daton në gjysmën e parë të shekullit të 6-të të hixhretit, me qendër në rrjedhën e mesme të lumit Niger, dhe udhëheqësit e saj morën qytetin Gao, në Malin e sotëm, si kryeqytet të tyrin. Udhëheqësi i parë i kësaj mbretërie ishte Dija' ibn Kajs. Populli i kësaj mbretërie pasi u konvertuan në Islam dhe mësuan gjuhën arabe, treguan interes për letërsinë, shkencën dhe shkrimin. Kufijtë e kësaj mbretërie u zgjeruan, duke përfshirë shtetet e Ganës dhe të Malit. Kjo mbretëri filloi të degradohej me ardhjen e portugezëve atje.

Mbretëria Kanem ishte krijuar në cepin më të largët të Lindjes - në Afrikën Perëndimore - rreth liqenit Çad, dhe autoriteti i saj u shtri deri në tokat e Ganës dhe Malit në perëndim. Një nga dijetarët e Perëndimit ka thënë për këtë mbretëri se: Ajo ishte profesoresha e Qytetërimit Sudanez, i përkiste dhe ndiqte fenë Islame, shkruanin me shkronja arabe, dhe i kontrollonte rrugët më të rëndësishme tregtare që lidhnin rajonin me bregdetin e Mesdheut.

Tregtia luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e Islamit dhe të kulturës arabe në Afrikën Perëndimore. Tregtarët muslimanë njiheshin për ndershmërinë, pastërtinë e moralit dhe sjelljet e mira, dhe kjo ishte një nga arsyet e hyrjes së shumë afrikanëve në Islam. Disa nga tregtarët merreshin me tregti, por edhe me shkencë e dituri në të njëjtën kohë, dhe të tillët formonin klasa për mësimin e Kur'anit Famëlartë.

Gjithashtu, Haxhi pati një rol të rëndësishëm në përhapjen e Islamit, pasi sulltanët e vendeve islame në Afrikën Perëndimore ishin të prirur për ta kryer këtë detyrë, dhe fiset Hausa ishin ndër më të eturit për të kryer Haxhin. Shumë dijetarë dhe klerikë nga vende të ndryshme islame u dyndën në Afrikën Perëndimore për të dhënë mësim, në shkolla dhe xhami, në Timbuktu, Xhena, Mali, dhe qytete të tjera të Afrikës Perëndimore, pasi e ndjenin këtë si detyrë ndaj vëllezërve të tyre në këtë rajon, kështu që ata kontribuuan në përhapjen e kulturës arabe dhe islame atje.

Përhapja e Islamit në Afrikën Perëndimore ishte e lidhur gjithashtu edhe me lëvizjet reformuese, të cilat u nisën me synimin për të çliruar fenë nga papastërtitë që i ishin ngjitur. Këta liderë arritën të mblidhnin rreth tyre një numër të konsiderueshëm ndjekësish, pasi këta të fundit panë devotshmërinë dhe drejtësinë e këtyre prijësve. Njëra nga këto lëvizje ishte lëvizja e Shejh Othman ibn Fuda, i cili mundi të udhëheqë fiset Fulani, dhe të themelojë Sulltanatin Sokoto, i cili luajti një rol të rëndësishëm në përhapjen e Islamit në Afrikën Perëndimore.

Si rezultat i përpjekjeve të mëparshme të fiseve arabe, reformatorëve, predikuesve dhe tregtarëve myslimanë, Islami u përhap në Afrikën Perëndimore dhe vende të tilla si Nigeria, Gambia, Senegali, etj, u bënë vende me shumicë myslimane.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

Lumi Gambia

https://en.wikipedia.org
https://islamonline.net
https://ar.wikipedia.org
https://www.britannica.com
https://www.marefa.org

ERDOGAN: ISLAMI SYNON TA ZBUKUROJË BOTËN DHE TA BËJË MË TË JETUESHME PËR TË GJITHA KRIJESAT

Presidenti Recep Tayyip Erdogan tha se lufta e Turqisë, si në marrëdhëniet ndërkombëtare ashtu edhe në ekonomi, me sloganin 'Bota është më e madhe se pesë' është për ndryshimin e këtij rendi të ndërtuar mbi shfrytëzimin dhe shtypjen.

Presidenti Erdogan mbajti një fjalim në ceremoninë e 8-të të ndarjes së Çmimeve "Necip Fazil" të zhvilluar në Qendrën e Kulturës Ataturk (AKM) në Stamboll.

Duke shprehur se ndryshimi është një realitet i jetës, po se ka një ndryshim të mprehtë midis ndryshimit dhe korrupsionit, Erdogan tha: "Njerëzimi ka përjetuar një transformim të madh, degjenerim në një aspekt, në të cilin vlerat e tij të lashta janë dëmtuar në 2 shekujt e fundit. Krahas modernizimit, perspektiva e njerëzve ndaj natyrës së tyre, mjedisit dhe krijesave të tjera me të cilat ndajnë jetën ka ndryshuar gjithashtu."

"Lufta e Turqisë me sloganin "Bota është më e madhe se pesë" si në marrëdhëniet ndërkombëtare ashtu edhe në ekonomi është për ndryshimin e këtij rendi të ndërtuar mbi shfrytëzimin dhe shtypjen. Ne refuzojmë çdo qasje që zhvlerëson njeriun, më të nderuarin nga të gjitha krijesat. Ne besojmë se qytetërimi islam, me mesazhet e tij që kapërcejnë epokat, ofron një recetë shpëtimi për depresionet brenda të cilave ndodhen njërit modernë. Qytetërimi islam, i bazuar mbi themelet e shkencës, urtësisë, moralit dhe drejtësisë, synon ta zbukurojë botën dhe ta bëjë atë më të jetueshme për të gjitha krijesat", tha Presidenti Recep Tayyip Erdogan.

(www.trt.net.tr/shqip)

SKLLEVËRIT E ARBRIT

Me përjashtim të një studimi të Ardian Muhaj dhe disa përmendjeve sporadike, gati gati luksoze, historiografia zyrtare shqiptare e ka anashkaluar fenomenin e skllavërisë në tokat arbërore të Mesjetës së Vonë, si në aspektin e pranisë ashtu edhe në atë të tregtisë, megjithëse prej viteve '50 kanë qarkulluar studime tashmë klasike, si ato të Charles Verlinden e David Davis, apo, në mënyrë më specifike, Domenico Gioffré, Anna Spinelli e sidomos Laura Balletto. Cambridge University Press ka publikuar rishtazi një përmbledhje të përditësuar, ku fenomeni del sërish në pah:

«Andej nga Adriatiku, Raguza shërbente si qendër e një tregtie të lulëzuar skllevërish, e ndërmjetësuar nga Venediku. Fëmijët shqiptarë të shitur përmes Durrësit ishin subjekt i një morie ligjesh të aprovuar nga Senati venedikas në vitet '80 të shek. XIV. Këto fëmijë, të quajtur anime (shpirtra), nuk ishin tamam skllevër, për shkak të origjinës së krishterë. Statusi i tyre duhej të ishte i ngjashëm me atë të shërbëtorëve me kontratë, të detyruar që të shlyenin një borxh përgjatë disa viteve. [...] Ligjet e reja përcaktonin se shpirtrat mund të punonin maksimumi katër vjet për të paguar shpenzimet e transportit të tyre deri në Venedik. Ky limit kaloi më pas në 10 vjet. Pronarët e tyre ishin të detyruar t'i regjistronin pranë autoritete të lagjeve (capisestrieri) dhe nuk mund t'i mbanin pa limit e as t'i shisnin jashtë Venedikut. Përditësimet e ligjeve tregojnë se venedikasit vazhduan të mbanin shpirtra deri në shek. XV dhe t'ua shisnin mjeshtërve në Lombardi, Toskanë e Trentino»*.

Bëhet fjalë për tregti fëmijësh në një epokë kur koncepti "fëmijë" nuk përkonte me limitin 18 vjeç. Gjithashtu, këto ngjarje janë të shënuara në regjistrat venedikas në po ato vite ku ndonjë syresh pretendon të ketë zbuluar deri edhe kurrikulat e Universitetit të Durrësit.

**Barker H., "The trade in slaves in the Black Sea, Russia and Eastern Europe", në Perry C., Eltis D., Engerman S., Richardson D. (përg.), "The Cambridge world history of slavery, 500-1420", vëll. II, Cambridge University Press, 2021, pp. 99-122.*

(fb: Post Bllok)

ME IDE ATEISTE NUK SHKOHET KUND

Ajni Sinani

Me ide ateiste nuk shkohet kund. Ju ateistë shkruani libra për ti mbuluar pluhuri. Kosova është shtet laik! Po edhe ShBA është shtet laik ama presidenti dhe funksionarë të tjerë i referohen Bibles. Meqenëse Kosova është laike nuk u lejueka që Kryeministri të lexojë ajet kuranor apo hadithe.

Kur ishim në socializëm, shqiptarët tanë komunistë në emër të socializmit shkatërruan xhami e ishin kundër fesë. Tani në emër të laicizmit disa zëra të mekur kërkojnë që Kryeministri të mos flasë asgjë nga feja sepse shkel laicizmin!

Sa i lëndueshëm dhe sa lehtë i cenueshëm na qenka ky farë laicizmi i këtyre laikëve tanë.

Me ateizëm o burra nuk shkohet kund. Lërini zotat tuaj imagjinar e të rremë. Kthejuni të Vërtetës! Fjala e Zotit është mbi çdo fjalë.

PËRMBYLLET CIKLI I DYTË I LIGJËRATAVE FETARO-PSIKOLOGJIKE PËR GRATË

Në muajin dhjetor 2021, u zhvillua edhe përmbyllja e ciklit të dytë të ligjëratave fetaro-psiklologjike me titull "Përmirësimi i rrugëtimit tim në Islam", për femra në xhaminë "Ebu Bekër", në qytetin e Shkodrës, të mbajtura nga teologia Zamira Bushati (Puka) në bashkëpunim me Myftininë Shkodër.

Javë pas jave, gjatë muajve shtator-dhjetor janë trajtuar tema të ndryshme, të cilat kanë qenë një mundësi reflektimi dhe permirësimi. Në qendër të këtyre ligjëratave ka qenë analizimi shumëdimensional i individit në këndvështrimin fetar dhe psikologjik. Duke filluar që me Gjithësinë e meditimin në të, në përsosmërinë e krijimit të njeriut dhe në vlerat që i jep atij identiteti islam, njeriu e gjen veten të lartësuar mbi çdo krijesë. Duke vazhduar, me vetedijësimin se adhurimi është qëllimi i krijimit të njeriut, por edhe përmbushje shpirtërore për të, e ku muslimani e ngjyros të gjithë veprimtarinë e tij me "sibgah" ngjyrën e Allahut. Pa harruar se shembullin më të mirë të të jetuarit sipas parimeve të Islamit, gjendet tek Profeti a.s dhe tradita e tij, i cili na mëson se për çdo nevojë "ilaçin"e gjejmë tek Shpallja Hyjnore. Në këtë mënyrë, Islami është referenca, pasqyra, peshorja, e manuali nëpërmjet të cilit muslimani i jep formë vetes dhe veprave te tij, sepse udhëzimet e Islamit promovojnë standarde të larta të punës, e që shpërblimet për to shkojnë përtej pritshmërisë tonë. E kështu, çelësi i lumturisë së përhershme është të pasurit e Islamit pjesë të pandashme të përditshmërisë tonë.

Një falenderim i veçantë shkon për të gjitha motrat muslimane që u bënë pjesë e këtij aktiviteti. Por pa harruar të falenderoj edhe ekipin organizues, shumë vajza të reja të cilat kontribuan në realizimin dhe mbarëvajtjen e tij, me recitimin e Kur'anit, trajtimin e disa temave, këndimin e ilahive, recitimin e poezive, etj. Një mirënjohje e veçantë shkon për psikologen Admira Guri; për farmacisten Ela Zhabjaku; për studenten e Shkencave Kompjuterike Saelda Rrahi, studente në Zagreb të Kroacisë; për studenten në Këshillim dhe Udhëzim Psikologjik Almeda Tusha, në Stamboll të Turqisë; për studenten e Matematikës Sharuana Myselimi, në Shkodër; si dhe për shumë vajza dhe nxënëse të Medresesë së Shkodrës. Allahu ua shpërbleftë të gjithave me mirësitë e Tij të pafundme! Së bashku jemi munduar, që çdo e shtunë të ishte një stacion ripërtëritjeje e përmirësimi për pjesëmarrëset, për të vazhduar më të përmbushura e më të vendosura në rrugëtimin tonë të dynjasë, drejt destinacionit të synuar, xhenetit në Ahiret.

Lusim Allahun të na mundësojë të bëjmë vepra të mira e të sinqerta, që këto aktivetete e shumë të tjera, të kenë sukses e të pranohen nga ana e Tij! Na e bëftë punën tonë të mirë shkak për të hyrë në mëshirën dhe në xhenetet e Tij!

AKTIVITET KULTUROR PËR DITËN BOTËRORE TË GJUHËS ARABE

Paraditen e ditës së shtunë, më 18 dhjetor 2021, Myftinia Shkodër zhvilloi një aktivitet kulturor me rastin e 18 dhjetorit, të shpallur nga UNESCO si Dita Botërore e Gjuhës Arabe.

Përveç përfaqësuesve dhe imamëve të Myftinisë, ishin të pranishëm edhe intelektualë të qytetit, të rinj dhe dashamirës dhe njohës të gjuhës arabe.

Teulogu Arben Halluni në fjalën e tij të hapjes tha se ky është aktiviteti i parë që organizon Myftinia Shkodër për gjuhën arabe, si gjuha e Islamit dhe e Kuranit, gjuhë që flitet nga rreth gjysmë miliardi njerëz anë mbanë botës, gjuhë që është përfshirë zyrtarisht si gjuha e gjashtë e OKB-së (Organizatës së Kombeve të Bashkuara). Duke treguar vlerën dhe rëndësinë e saj, vuri në dukje se kohët e fundit Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) ka vendosur Kaligrafinë Arabe në listën e trashëgimisë kulturore jomateriale.

Më pas, teologu Lavdrim Hamja gjatë referimit të tij foli në lidhje veçoritë dhe elementët dallues të kësaj gjuhe të lashtë, historikun e saj, statistika për vendet që e përdorin si gjuhë amtare, por edhe për shtrirjen e saj në çdo vend të botës.

Teologu Hamja ndër të tjera tha, se: "Gjuha arabe arriti të ishte gjuha e të gjitha shkencave gjatë epokave islame dhe të bëhej një mjet për të shprehur idetë që nga shekulli i parë i migrimit (hixhretit). Kështu arabishtja arriti të bëhet gjuha e shkencës në vendet e saj të reja dhe të kalojë nga të qenit një gjuhë me origjinë beduine (nomade), në një gjuhë ndërkombëtare, për arabët dhe joarabët, muslimanët dhe të tjerët e praktikonin në marrëdhëniet dhe shkrimet e tyre".

Në fund të këtij aktiviteti foli edhe z. Muamer Vuci, kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri -Vende Arabe, i cili u ndal rreth temës: "Përhapja e arabishtes në trojet shqiptare".

Z. Vuci u ndal edhe tek lidhjet e forta dhe të hershme të shqiptarëve me botën arabe, qofshin këto lidhej fetare, kulturore, tregtare, politike, etj.

MYFTIU: "FALË UDHËZIMIT ISLAM JETOJMË SI NJERËZ ME VLERA!"

Ditën e mërkurë, më 22 dhjetor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një ligjëratë pas namazit të akshamit në xhaminë e fshatit Kullaj, Postribë.

Në fillim, Myftiu falënderoi besimtarët e pranishëm, që përtej temperaturave të ulëta të ditëve të fundit, ishin të pranishëm në xhami për faljen e namazit të akshamit me xhematë dhe ligjëratës së Myftiut.

Në vasin e mbajtur këtë natë, Myftiu iu qas rëndësisë që ka kuptimi i thirrjes: "Allahu ekber", që muslimanët e përsërisin çdo ditë me dhjetëra herë.

Myftiu tha se tekbiri është simbol dhe nxitje e të mirës e lartësimit në jetë, në çdo kohë e çdo situatë.

Ai tha se përtej propagandave të djallëzuara për ta mjegulluar dhe bërë të urryer për njerëzimin këtë thirrje të shenjtë, asgjë nuk duhet ta stepë muslimanin për ta dëshmuar madhështinë dhe shenjtërinë e kësaj thirrjeje shekullore, me të cilën, krejt të dërguarit e Allahut e ftuan njerëzimin drejt krenarisë së besimit, dinjitetit të jetuarit si mëkëmbës të Zotit dhe njerëz me vlera dhe dritë!

MYFTIU: "TË PËRMIRËSOJMË BASHKËPUNIMET NË MESIN E MYFTINIVE TË ZONËS!"

Ditën e mërkurë, më 22 dhjetor 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një bashkëbisedim vëllazëror me Myftiun e Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj.

Në takimin e përzemërt, ku prezantonte edhe administratori i Myftinisë Shkodër, z. Sajmir Dritareti, Myftiu Sytari vuri theksin tek domosdoshmëria e përmirësimit të cilësisë së bashkëpunimeve në mesin e myftinive të zonës së Shkodrës.

Ai tha se mundësitë janë për të bërë akoma më shumë e më mirë për të mirën e besimtarëve, misionit të xhamive dhe angazhimit legjitim të myftinive përkatëse në drejtim të rritjes së komunikimit dhe hapjes së rrethit të bashkëpunimeve që e gjallërojnë edhe më tej jetën fetare në qytetet e zonës së Shkodrës.

Të dy myftilerët e nderuar u ndalën në detaje në pika të shumta, ku mund dhe duhet të përqendrohet vëmendja për të mirën e përbashkët.

I RIU BELG DËSHMON SHEHADETIN PARA DUARVE TË MYFTIUT TË SHKODRËS

Ditën e mërkurë, më 22 dhjetor 2021, në xhaminë e Parrucës u zhvillua ceremonia e hyrjes në Islam e të riut belg Jules, që në përputhje me etiken dhe rregullat islame, e dëshmoi shehadetin para Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në një postim tijin, Myftiu e përshkroi kështu emocionin dhe ndjesinë e tij të kësaj ndodhie të veçantë:

"Belgu Jules, e pranoi sot Islamin!

Një emocion i jashtëzakonshëm dhe një ndjesi e mrekullueshme, teksa ndjeja sinqeritetin dhe dorëzimin e tij në këtë bejat shekullor, që përsëritet brez pas brezi në madhështinë e dëshmisë së madhe: "Do të mbërrijë kjo fé, ku ka mbërritur nata dhe dita", dëshmi që na e shton edhe më shumë lidhjen dhe dashninë e Resulullahut (a.s)!

Mirë së erdhe në familjen tënde të madhe, i dashtuni Jules!

Imam Muhamed B. Sytari"

Viteve të fundit, numri i evropianëve dhe perëndimorëve që po pranojnë Islamin, sa vjen e rritet duke u kthyer në një fenomen të natyrshëm dhe një bekim për njerëzimin!



Pejgamberi (a.s) kur dërgonte ndonjërin prej shokëve të tij në ndonjë dërgesë (thirrjeje islame), i thoshte:

"Jepni sihariq dhe mos i largoni njerëzit, lehtësoni dhe mos vështirësoni!"

(Transmetuar nga Ebu Davudi dhe Muslimi)

LIGJËRATË ME DOBI PËR MOTRAT MUSLIMANE

Paraditën e së shtunës, më 25 dhjetor 2021, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet të veçantë për motrat muslimane.

E ftuar speciale e këtij aktiviteti ishte teologia Merjem Lumi, e cila bashkëbisedoi dhe ligjëroi rreth rrugëve të afrimit me Zotin, rregullimin e marrëdhënieve me njerëzit e me Zotin, pendimin, etj.

Gjatë ligjëratës së saj, teologia Merjem Lumi drejtoi pyetje të shumta dhe dha mendimet dhe zgjidhjet për shumë tematika delikate që shqetësojnë sot besimtarët, motrat në veçanti.

Prania e madhe e motrave dëshmoi për domosdoshmërinë e këtyre tubimeve, ku trajtohen çështje të ditës dhe që zgjojnë vëmendjen e besimtareve në rrugën e përmirësimit dhe ruajtjes së ekuilibrave të besimit dhe fetarizmit të shëndoshë në jetë.

NJË MIK I SHTRENJTË, QË ZEMRËN GËZON!

Mbrëmjen e së shtunës, më 18 dhjetor 2021, më begatoi me vizitën e tij, ing. Nurudin V. Gavoçi, djali i madh i Hoxhës tim, H. Vehbi S. Gavoçi, rahmet pastë.

Prania e tij më solli erën e Hoxhës, butësinë e tij, djegien e zemrës për këtë fé, dashninë pa kushte për Shkodrën, për të cilën shkruante dhe dëshmonte me të madhe: "Mburrem që jam shkodran!"

Prania e tij më solli erën e Hoxhës, butësinë e tij, djegien e zemrës për këtë fé, dashninë pa kushte për Shkodrën, për të cilën shkruante dhe dëshmonte me të madhe: "Mburrem që jam shkodran!", vullnetin për t'i shërbyer kërkuesve të dijes, heshtjen e urtë, fjalën e matur e plot ëmbëlsi, përballjen plot dinjitet me bidatet e reja të taborrave të jomedhhebizmit dhe përçarjes, mbrojtjen me krenari të trashëgimisë shekullore të dijetarëve të ymetit e, në veçanti, imamit të imamëve të fikhut islam, Ebu Hanife Numanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)!

U ndriçua shtëpia, u gëzuan familjarët, m'u mbush zemra plot me dritë malli e nur dashnie të palëkundur për zotninë tim, me të cilin, Allahu më takoi, për të më nxjerrë nga realitetet e një bote pa ngjyrë e dritë, drejt hapësirave pafund të dritësisë së dijes e përkushtimit, ngjyrimit islam e bardhësisë së dorëzimit para duarve të Mjeshtrave të mëdhenj botëror të Thirrjes Islame të këtij shekulli!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari
Shkodër, më 18 dhjetor 2021

ZHVILLOHET KONFERENCA E 10-TË VJETORE E IMAMËVE ME TEMË: “KURANI, MREKULLIA UDHËZUESE”

Ditën e diel paradite, më 26 dhjetor 2021, në ambientet e xhamisë së “Dy Vajzave”, Myftinia Shkodër zhvilloi konferencën e 10-të vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës.

Në këtë konferencën të përvitshme, përveç imamëve, anëtarëve të këshillit të Myftinisë, përfaqësuesve të këshillave të xhamive, mori pjesë Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari si dhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, pasi përshëndeti imamët dhe të pranishmit, mbajti referatin me temë: “Ai (Kurani) është nder për ty dhe për popullin tënd; e ju do të pyeteni!” – (Ez-Zuhruf: 44), duke u ndalë tek komentimi i këtij ajeti madhështor të Kuranit Famëlartë.

Konferenca u zhvillua në dy seanca dhe përfshinte 12 referate, ku në seancën e parë u mbajtën këto referate:

– Kurani, mes vlerës së leximit dhe kuptuarit të drejtë të tij, nga H. Lavdrim Hamja, imam – xhamia e “Dy Vajzave”

“Ky Kuran udhëzon drejt asaj, që është më e drejtë” – (El-Isra: 9), nga H. Ardit Hoxha, imam – xhamia Shirokë

– Historia e tefsirit të Kuranit, nga H. Idmir Plaku, imam – xhamia “Ebu Bekër”

– Specifikat dhe ndikimet e jashtëzakonshme të Kuranit, nga H. Naim Drijaj, imam – xhamia Parrucë

– “Le të sjellin një fjalë të ngjashme, si ai, nëse janë të sinqertë” – (Et-Tur: 34), nga H. Ruzhdi Plangaj, imam – xhamia Kiras

Ndërsa, seanca e dytë kishte këto referate:

– “Ne e kemi zbritur ‘Dhikrin” (Kuranin) dhe Ne e mbrojmë atë” – (El-Hixhr: 9), nga H. Durim Kasemi, imam – xhamia Parrucë

– “Ky është libri, që nuk ka dyshim në të...” – (El-Bekare: 2), nga H. Ervil Kuçi, imam – xhamia Dërgut

– “Ne e kemi zbritur atë, Kuran arabisht, që ju ta kuptoni” – (Jusuf: 2), nga H. Gilman Kazazi, imam – xhamia “Ebu Bekër”

– Roli i Kuranit në arritjen e udhëzimit të njeriut, nga H. Besim Barbullushi, imam – xhamia Rus

– “Dhe, zbresim nga Kurani, çfarë është shërim dhe mëshirë...” – (El-Isra: 82), nga H. Ensar Ismajlaj, imam – xhamia Dërgut

– “Ne e kemi zbritur atë, në Natën e Kadrit” – (El-Kadr: 1), nga teologu Arben Halluni.

Këtë konferencë e përshëndeti edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj.

Gjatë kësaj konference u prezantua edhe botimi i librit të konferencës së 9-të, vjetore e imamëve, e cila u mbajt vitin e kaluar, në të cilën gjenden të plota referatet e imamëve të nderuar.

Gjithashtu, vlen të përmendet, se edhe punimet e referateve të mbajtura në konferencën e 10-të të këtij viti, do të botohen të plota në librin e përvitshëm të konferencës.

MEJTEPI I IM... XHAMIA GANJOLLË

PAK HISTORI:

- Xhamia Ganjollë, ndodhet në Njësinë Administrative “Gur i Zi”, Shkodër.

- Përbëhet prej 50 familjeve myslimane.

- Fiset më të njohura të këtij fshati janë: Mali, Ceni, Tahiri, Alija, Murati dhe Kjasi

- Me iniciativën e besimtarëve dhe kontributin e të gjithë banorëve si dhe të Myftinisë Shkodër në vitin 2008 rindërtohet xhamia e fshatit Ganjollë.

- Në xhaminë (e vjetër dhe më pas rindërtimit të saj) Ganjollë nga viti 2002 e deri më sot kanë shërbyer imamë dhe mësues të mejtepeve: Xhavid Sokoli dhe imami e mësuesi aktual, Erion Hasmegaj.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 9 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2021 është rreth 125 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, në vazhdën e vizitave dhe takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë rregullisht kurset-mejtepet e mësim-besimit, më 31 dhjetor 2021 drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Ganjollë.

Teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin, si përçimin te brezi i ri i mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami, Erion Hasmegaj.

Gjatë këtij takimi pati pyetje dhe përgjigje rreth njohurive që marrin nxënësit nga ky mejtep fetar si dhe u bë prezantimi i disa aktiviteteve arsimore dhe argëtuese që do të zhvillohen gjatë vitit 2022, përmes një plan-programi të hartuar për të gjitha mejtepet dhe kurset fetare qe zhvillon Myftinia Shkodër në zonën e saj.

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Çdo VEPËR FISNIKE është SADEKA!"

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek